



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Prispeno / Predate Received / Delivery	08 . 11 2018	viti god year	
Organ / Bënie Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. No. Prot. Prot.No:	Shtesa Prijlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHCK	6693/2018		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. 627/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Shkëmb Manaj- kryetar, Lela Petkovic dhe Hajzer Salihu- anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.627/2018, të datës 04.10.2018, së ankuesit Fahredin Sharku, me adresë banimi, rruga "Shejit Mihidin Shehu", pa numër, nga Komuna e Rahovecit, me përfaqësues juridik Qazim Qeska, kundër organit të punësimit Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike " kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.11.2018, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A. Nr. 627/2018, të datës 04.10.2018 të parashtruar nga ankuesi Fahredin Sharku.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Rahovecit, me datën 26.04.2018, me numër protokolli 01, Nr. 1463/2018, ka nxjerr vendim lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil, Fahredin Sharku, duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesi Fahredin Sharku, i pakënaqur me vendimin e nxjerr nga Kryetari i Komunës së Rahovecit lidhur me arritjen e moshës së pensionimit me të cilin i ka njohur të drejtën e një pagë, sipas dispozitave ligjore në fuqi me datën 25.05.2018, me numër protokolli 1705, i është drejtuar me ankesë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Rahovecit, nuk ka nxjerr vendimin brenda afatit ligjor lidhur me ankesën e ankuesit për kompensimin e pagave pas arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesi Fahredin Sharku, i pakënaqur me mos marrjen e përgjigjes nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Rahovecit, për mes postes së Kosovës, me datën 02.10.2018, ka parashtruar ankesë e cila ankesë është pranuar me datën 04.10.2018 me numër protokoll 5721//2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datën 05.10.2018, me numër protokoll 5744/2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Rahovecit, ndërsa me datën 15.10.2018 me numër protokoll 5994/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Rahovecit, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.627/2018, e datës 04.10.2018, me numër protokoll 5721/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesa e datës 27.08.2018, drejtuar Kryetarit të Komunës; përgjigje në kërkesë e datës 14.09.2018; Ankesë e datës 25.05.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi i datës 26.04.2018, me numër protokoll 01, Nr. 1463, për arritjen e moshës së pensionimit; Vendimi i datës 26.02.2018, për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dëshmi për pranimin e vendimit; Akt pajtimi i datës 26.06.2018; përgjigje në ankesës e datës 15.10.2018, me numër protokoll 5994/2018, me shkresat e bashkangjitura;


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Fahredin Sharku, është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi me datën 25.05.2018, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Podujevës, ndërsa kundër heshtjes administrative, ankuesi ka parashtruar ankesën përmes postes së Kosovës, me datën 04.10.2017 me numër protokoll 5721/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e që është jashtë afatit ligjor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi ankesën e ka parashtruar, jashtë afatit ligjor prej gjashtëdhjetë (60) ditësh për shkak të heshtjes administrative, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se " *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën



kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 627/2018,

Shkëmb MANAJ

Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit; Fahredin Sharku.*
- *Përfaqësuesit Juridik avokatit Qazim Qeska;*
- *Kryetarit të Komunës së Rahovecit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Rahovecit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

